



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës 1Nr.020-319 të datës 31.03.2010, Kryetari i Komunës, nxjerr

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR STRUKTURËN ORGANIZATIVE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS 1Nr.112-26216 i datës 23.05.2017

Neni 1 Përbërja

Formohet Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për strukturën organizative të administratës së Komunës, 1Nr.112-26216 të datës 23.05.2017, (në vazhdim të tekstit Komisioni) në këtë përbërje:

1. Xhevahire Zeqiri, Udhëheqëse e Personelit, kryesuese
2. Visar Kozhani, Zyrtar Kryesor Financiar, anëtar
3. Vlora Krasniqi, Shefe e Sektorit për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
4. Shaban Syla, Shef i Sektorit për Buxhet dhe Financa,
5. Radmila Simijenovic, Shefe e ZLK-së, anëtare

Neni 2 Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Detyrë e Komisionit është që ti propozojë Kryetarit të Komunës për miratim aktin me ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit mbi strukturën organizative të Komunës duke i harmonizuar ato me Katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil, ku përfshihen si vijon:

1. Harmonizimi i emërtimeve të vendeve të punës në administratën komunale
 2. Harmonizimin e koeficientëve të pagave të shërbyesve civil
 3. Llogaritjen e kostos financiare të ndryshimit eventual për pagat e administratës komunale
- Detyrat e lartëcekura Komisioni duhet ti kryej më së largu me date 28.02.2018

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 112-4299
Lipjan, më 22.01.2018

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

